



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Sintaksë e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore 20 leksione/20 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme e Departamentit
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon mësimin e gjuhës turke nëpërmjet një metode të njohur. Lënda është e organizuar në leksione dhe seminare dhe shërben si praktikë për të zhvilluar kompetencat gjuhësore të studentëve në gjuhën turke Përdorimi dhe zbatimi i teorisë së strukturave gjuhësore në praktikë do të jenë qenësore, brenda dhe jashtë një konteksti të caktuar, thelbësore këto për procesin e mësimdhënies dhe të përkthimit.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore të tilla gjymtyrwt kryesore tw fjalisw, llojet e fjalisw etj
- 2.Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të identifikojë dhe veçojë konceptet dhe format themelore të strukturave gjuhësore të turqishtes

Rezultatet e pritshme:

- 1.Njohë dhe analizojë konceptet themelore të gramatikës së gjuhës turke, si gjymtyrët kryesore të fjalisë dhe llojet e saj.
- 2.Identifikojë dhe zbatojë format bazë të strukturave gjuhësore të turqishtes, si në të folur ashtu edhe në të shkruar.
- 3.Përdorë njohuritë gramatikore në mënyrë të saktë dhe funksionale, në kuadër të ushtrimeve praktike, komunikimit të përditshëm dhe përkthimit